



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.153/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryesues, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti -anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës- PDK me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 25.01.2025, merr këtë:

VE N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.153/2025 e datës 23.01.2025

II. Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës- (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 3,000.00 (tremijë) euro.

III. Detyrohet Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës- PDK, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 23.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se Kandidati për deputet nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës- (PDK), Faruk Bojaxhi, ka postuar një fotografi në llogarinë e tij në Facebook me tekst shoqërues të realizuar me hapësirat e brendshme dhe të jashtme të bashkisë islame dhe Iqeshvisë së Prizrenit, në kundërshtim me dispozitat ligjore zgjedhore duke shfrytëzuar kështu burimet dhe institucionet fetare për qëllime elektorale dhe duke bërë thirrje që të votohet subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me numër 131, kandidati për kryeministër Bedri Hamza dhe Faruk Bojaxhi.

Sipas parashtruesit të ankesës theksohet se me këtë veprim është shkelur nenin 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Rregullores Zgjedhore 07/202

Sipas parashtruesit të ankesës me këtë veprim subjekti përkatës ka cenuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore ndaj kërkojnë që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

Më datë 24.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 25.01.2025.

Në përgjigjen në ankesë të datës 25.01.2025, të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), theksojnë se në të kuptuarit për ekzistimin e veprimeve të tilla në të njëjtën ditë kanë marrë masa përmisuese për evitimin e shkeljes së pretendua në ankesë. Me të cilën kanë obliguar Faruk Bojaxhi që të bëjë heqjen ne postimit në rrjetin social facebook.

Në vazhdim të përgjigjes në ankesë theksojnë se nuk përjashtojnë mundësinë që edhe në vijim të ketë veprime të tilla të përkrahësve, votuesve dhe simpatizantëve të PDK-së, e të cilat mund të jenë në kundërshtim me rregulloren 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve si dhe Ligjin nr.08/L-228 i LZP-së, pasi që nuk është e mundur që të mbahen në kontroll të gjitha veprimet e simpatizantëve, përkrahësve dhe votuesve të PDK-së, mirëpo PDK-ja garanton se çdo herë në çdo rast do të marrë masa përmisuese për evitimin ne këtyre shkeljeve.

Kërkojnë nga PZAP-i që të refuzohet ankesa e pabazuar pasi që ndaj veprimeve të pretenduara janë ndërmarrë të gjitha masat për evitimin e pasojave të kësaj shkelje.

Përgjigjes në ankesë ka bashkangjitur si provë videon dhe postin që dëshmon fshirjen e publikimit të postimit në facebook nga Faruk Bojaxhi dhe udhëzuesin e subjektit të tyre politik për rregullat e fushatës zgjedhore.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

Ankesa është bazuar

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore dhe përgjigjen në ankesë, ka gjetur se postimi i fotografisë në llogarinë e facebook-ut të kandidatit për deputet nga radhët e Subjektit Politik PDK, Faruk Bojaxhi është vërtetuar se ka bërë fushatë me përfaqësues fetar dhe organizatave bamirëse. Nga prova materiale e bashkangjitur ankesës, së Subjektit Politik LVV, dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se nga ana e kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik, PDK, është shkelur Rregulla Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që kandidati në fjalë, me qëllim të promovimit të kandidaturës së tij për deputet, është zhvilluar me përfaqësues fetar, për fushatë zgjedhore, veprim ky i cili bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Rregullores Zgjedhore 07/2024.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e

subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.


Paneli ka marrë vendimin për lartësinë e gjobës ka vlerësuar rrethanë lehtësuese faktin që subjekti politikë në fjalë ka bërë përpjekje të arsyeshme për ta evituar shkeljen -heqjen e fotografisë të postuar në rrjete sociale facebook, që ishte vendosur nga kandidati për deputet Faruk Bojaxhi nga radhët e Subjektit Politik PDK.

Gjithashtu Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën përsëritje të shkeljes së legjislacionit zgjedhor, pra ka bërë shkelje të tilla edhe në proceset e mëparshme zgjedhore. Kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e fotografisë në rrjetin social facebook nga kandidati i subjektit të tyre politik për fushatë zgjedhore është takuar me përfaqësues fetar dhe përfaqësues të organizatave bamirëse, e cila është në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Rregullores Zgjedhore 07/2024.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, dhe nenit 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Rregullores Zgjedhore 07/2024, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.153/2025 më datën 25.01.2025

Kryesuese i Panelit
Ramush Bardiqi



Këshilla Juridike: Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.